



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,  
Ref:20.09.2017\572-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Genc Maxhunit kundër portalit të lajmeve  
Indeksonline**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Genc Maxhunit kundër portalit Indeksonline, i cili më 17 shtator 2017, ka publikuar një video-inçizim me tekst të ndërlidhur me titull "E tmershme, shikojeni se çka i bënë droga e rrezikshme këtij të riu të Prishtinë" lidhur me shkrimin, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se parashtruesi i kësaj ankese paraqitet në shkrim dhe video brenda në veturë, pa asnjë masë të ndërmarrë për fshehjen e identitetit të tij - me pamje denigruese dhe poshtuese për të.

Në ankesë thuhet se edhe nën supozimin se pala e dëmtuar është konsumues i substancave narkotike, ajo ka nevojë për shërim e jo për publikimin e fytyrës së saj.

KMShK konstatoi se në këtë lajm, nuk botohet emri i personit për të cilin supozohet se përdorë narkotik, por megjithatë shkelet Kreu VII (Privatësia), i cili thotë: "gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve do t'u shmnagen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të ndonjë individi, përderisa ndërhyrje apo kërkime të tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik".

Në rastin konkret nuk është në interesin publik për ta zbuluar atë identitet, andaj, është dashur që gazeta ta mbulojë fytyrën e tij.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**